

MENAXHIMI I DHIMBJES

1. Prezenca e dhimbjes diagnostikohet nëpërmjet:
 - a) Të dhënave objektive.
 - b) Të dhënave subjektive.
 - c) Anamnezës familjare.
 - d) Auskultacionit.
2. Dhimbje idiopatike i referohet:
 - a) Dhimbjes pa origjinë të identifikuar.
 - b) Dhimbjes me origjinë të identifikuar.
 - c) Limitit maksimal të rezistencës ndaj dhimbjes.
 - d) Limitit minimal të resitencës ndaj dhimbjes.
3. Si klasifikohet dhimbja që përjeton një pacient me krurgji abdominale:
 - a) Dhimbje idiopatike
 - b) Dhimbje akute.
 - c) Dhimbje kronike.
 - d) Dhimbje akute + kronike.
4. Suporti familjar që influencon në fenomenin e dhimbjes klasifikohet si:
 - a) Faktor fiziologjik.
 - b) Faktor psikologjik.
 - c) Factor fiziko-psikologjik.
 - d) Faktor social.
5. A është fenomen normal prezenca e dhimbjes në moshën e tretë:
 - a) Gjithmonë
 - b) Asnjë herë
 - c) Ndonjë herë.
 - d) Shpesh herë.
6. Përkufizimi më i saktë për dhimbjen do të ishte:
 - a) Një ndjenjë negative e shoqëruar me rezultate jo normale të testeve laboratorike.
 - b) Një ndjenjë negative e shoqëruar me ndryshime radiologjike.
 - c) Ndjenjë që merret e mirqënë ç'farë do që referon pacienti.
 - d) Ndjenjë që diagnostikohet nëpërmjet auskultacionit.
7. Pacientët me dhimbje kronike janë të prirur për:
 - a) Shtim të oreksit.
 - b) Ndryshim të gjëndies shpirtërore.
 - c) Gjumë të rehatshëm.
 - d) Funkcion normal jetësor.
8. Një pacient me dhimbje akute do të përjetojë:
 - a) Ndryshime në sistemin respirator.
 - b) Normalizim të presionit arterial.
 - c) Normalizim të pulsit periferik.
 - d) Normalizim të pulsit apikal.

9. Dhimbja klasifikohet si akute kur ajo zgjat:
- Më pak se 3 muaj.
 - Më shumë se 6-7-muaj.
 - Më shumë se 7-8-muaj.
 - Deri në 9-muaj.
10. Dhimbja klasifikohet si kronike kur ajo zgjat:
- Pak se 1-muaj
 - Nga 1-2 muaj
 - Nga 2-3 muaj
 - Mbi 3 muaj.
11. Gjatë reabilitimit të një artikulacioni infermierja duhet:
- Të ndihmojë pacientin në kryerjen e ushtrimeve me prezencë të dhimbjes por e durueshme.
 - Të ndihmojë pacientin në kryerjen e ushtrimeve dhe kur dhimbja është e padurueshme (që ushtrimi të jetë rezultativ).
 - Të kryej ushtrime pa arritur deri te dhimbja.
 - Të përdori analgjezikë për të shmangur dhimbjen gjatë kryerjes së ushtrimeve.
12. Cila nga procedurat e mëposhtme është pjesë e ndërhyrjes infermierore kur ajo përkujdeset për një pacient me dhimbje:
- Pyetet pacientin për anamnezën familjare.
 - Ofrimi i një libri për ta lexuar.
 - Marrja e informacionit lidhur me kohën e shfaqjes së dhimbjes.
 - Pyetet për medikamentet që ai ka përdorur për të dominuar dhimbjen.
13. Karakteristikë e dhimbjes kronike është:
- Zhdukja e dhimbjes deri në 3-muaj nga momenti i shfaqjes së saj.
 - Dhimbja vazhdon edhe pas shërimit të sëmundjes.
 - Përgjigjia e sistemit nervor simpatik.
 - Dhimbja zhduket kur ndodh shërimi.
14. Proçesi i fenomenit të dhimbjes kalon nëpër:
- 1 fazë.
 - 2 faza.
 - 3 faza.
 - 4 faza.
15. Gjatë rikuperimit të gjëndies shëndetësore pacienti referon për prezencë të dhimbjes. Cili është hapi i parë që ndërmerr infermierja në përkujdesje për këtë pacient:
- Të aplikojë një analgjezik të fortë sepse pacienti referon për dhimbje të padurueshme.
 - Interviston pacientin lidhur me dhimbjen që ai referon.
 - E inkurajon atë që dhimbja do të kalojë.
 - E siguron pacientin që dhimbja është bashkëudhëtare e sëmundjes.
16. Pas interventit të një ekstremiteti dhe bandazhimit të tij, pacienti përjeton edemë dhe shumë dhimbje. Si vepron infermierja?

- a) E observon pacientin pa ndërmarrë asnjë veprim.
- b) Komunikon me pacientin duke i thënë se do të kalojë.
- c) Bën lirim të badazhit për të siguruar qarkullimin normal të gjakut.
- d) E siguron pacientin që do të kthehet më vonë tek ai.

17. Karakteristika e dhimbjes sipërfaqësore është:

- a) Në formë rrahëse.
- b) Në formë therëse.
- c) Në formë kafshimi.
- d) Në formë shtrëngimi.

18. Një pacient që përjeton fenomenin e dhimbjes është i axhituar nga çdo gjë që e rrethon. Si duhet të veprojë infermierja?

- a) Të komunikojë me familjarët e pacientit.
- b) Të largojë vizitorët nga dhoma e pacienti dhe të marrë masa për lehtësimin e dhimbjes.
- c) Të komunikoj me mjekun pa bërë asnjë veprim.
- d) Të bëjë ajrosjen e dhomës.

19. Një pacient i sapo paraqitur në urgjencë ankohet për dhimbje abdominale. Që të marrë sa më shumë informacion për dhimbjen, infermierja duhet të drejtojë pyetjen?

- a) A keni dhimbje ?
- b) A është dhimbja konstante ?
- c) A është dhimbja shpuese ?
- d) Më trego për dhimbjen ?

20. Cili është ai reagim fiziologjik që ndodh tek një pacient me dhimbje:

- a) Çrregullim i respiracionit.
- b) Relaksim i muskujve.
- c) Vazodilatacion periferik.
- d) Ngushtim të pupilave.